

VENDIM
Nr. 216, datë 1.4.2026

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, dhe 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në listën e shkronjës “D”, të titulluar “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, hiqet 1 (një) kompani, renditur në shkronjën “a”, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë e shpallura bashkëpunëtore të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

NDRYSHIM NË LISTËN E KOMPANIVE TË SHPALLURA SI BASHKËPUNËTORE
APO FINANCUESE TË TERRORIZMIT
SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
(LISTA E OKB-së)

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME
ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Ndryshim në “Listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”:

1. AL-NUSRAH FRONT FOR THE PEOPLE OF THE LEVANT

Shënim. Gjenealitetet e tjera për kompaninë, emri i të cilës është renditur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.